Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 76/79/82/17
Datë/Datum 05.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.76-79-82/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Goran Milenković - Kryetar, z.Ekrem Salihu - Referues, z. Blerim Dina – Anëtar, z. Nuhi Paçarizi-Anëtar, z. Tefik Sylejmani-Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues në Konsorcium "Beni shpk & Euroing shpk"- Suhareke me nr. 82/17, OE "Laguna Sh.p.k"- Prishtinë me nr. 76/17, dhe OE "Uni project Sh.p.k"- Prishtinë me nr. 79/17, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit, iniciuar nga autoriteti kontraktues / Agjencia Qendrore e Prokurimit/, përkitazi me aktivitetin e prokurimit "Shërbime të pastrimit Lot 1dhe 10" Ri tender, me nr prokurimi "AQP 15/010/211", më datën 28.04.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohen,** pjesërisht si të bazuara ankesat e OE "Beni shpk & Euroing shpk"- Suharekë, OE "Laguna Sh.p.k"- Prishtinë, dhe OE "Uni project Sh.p.k"- Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Shërbime të pastrimit Lot 1 dhe 10" Ri tender, me nr prokurimi "AQP 15/010/211", i iniciuar nga autoriteti kontraktues / Agjencia Qendrore e prokurimit/.

II. **Anulohet,** vendimi për anulimin e aktivitetit te prokurimit te AK-së / Agjencioni Qendror i prokurimit /, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull "Shërbime te pastrimit Lot 1dhe 10" Ri tender, me nr prokurimi "AQP 15/010/211" dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorëve ekonomik ankues "Beni shpk & Euroing shpk"- Suhareke, OE: "Laguna Sh.p.k"- Prishtinë, dhe OE: "Uni project Sh.p.k"- Prishtinë, ju kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesat janë aprovuar si pjesërisht të bazuara.

V. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me datën: 24.02. 2016.

Hapja e ofertave është bërë me datën: 25.05.2016 dhe kane marre pjese, per Lot 1: 6 ofertues ndërsa për Lot 10: 5 ofertues.

AK ka formuar Komisionin per vlerësimin e tenderëve në përbërje prej tre anëtarëve me vendimin e dt.17.01.2017.

Data e njoftimit për anulimin e kontratës është 08.03.2017.

AK-AQP përmes Letrës standarde për tenderuesin e pasuksesshëm ka njoftuar "OE "Beni shpk & Euroing shpk"- Suhareke, "OE: "Laguna Sh.p.k"- Prishtinë dhe"OE: "Uni project Sh.p.k"- Prishtinë me datën: 08 dhe 09.03.2017.

Kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit te prokurimit , operatori ekonomik "OE Beni shpk & Euroing shpk"Suharekë, me datën: 13.03.2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit te prokurimit , operatori ekonomik "OE: "Laguna Sh.p.k"- Prishtinë, me datën: 13.03.2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit te prokurimit, operatori ekonomik "OE: "Uni project Sh.p.k"- Prishtinë, me datën: 13.03.2017, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me datën:14.03.2017, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesat për rishqyrtim të operatorëve ekonomik.

Operatori ekonomik "OE Beni shpk & Euroing shpk" - Suharekë, , si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më datën 23 Mars 2017 me nr. 82/17, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit teë prokurimit, me titull "Shërbime te pastrimit Lot 1 dhe 10", Ri tender me nr.prokurimi "AQP 15/010/211", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr.04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 6 i LPP-së – (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)
- Neni 7 i LPP-së-(barazimi ne trajtim/ Jo diskriminim)
- Neni 59 i LPP-së – (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
- Neni 60 i LPP-së – (Kriteri i dhënies se kontratës)
- Neni 69 i LPP-së- (Aftësitë teknike dhe/ose profesionale)

Operatori ekonomik : "Laguna Sh.p.k"- Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më datën 15 Mars 2017 me nr. 76/17, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit te prokurimit, me titull:"Shërbime te pastrimit Lot 1 dhe 10" Ri tender, me nr. prokurimi "AQP 15/010/211", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 59 i LPP-së – (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)

Operatori ekonomik "Uni project Sh.p.k"- Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më datën 17 Mars 2017 me nr. 79/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Shërbime te pastrimit Lot 1 dhe 10" Ri tender, me nr prokurimi "AQP 15/010/211", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 1 i LPP-së – (Qëllimi)
- Neni 6 i LPP-se-(Ekonomiciteti dhe efikasiteti)
- Neni 7 i LPP-se-(Barazia ne trajtim/Jo diskriminim)
- Neni 59 i LPP-së – (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
- Neni 65 i LPP-së – dhe
- Neni 72 i LPP-së – (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë)

- Neni 17 i Rregullave te Prokurimit Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-teknik, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik përmes raportit të datës 03 prill 2017, mendon që autoriteti kontraktues Agjencia Qendrore e prokurimit/, lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull: "Shërbime te pastrimit Lot 1 dhe 10"Ri tender, me nr prokurimi "AQP 15/010/211" ne përputhje me nenin 114 pika 2 te LPP-se, megjithatë te mbaje ne fuqi vendimin për anulimin e aktivitetit te prokurimit, të vlerësohet ankesa e OE Laguna sh.p.k si pjesërisht e bazuar ndërsa ankesat e OE- Uni-Project dhe Beni&Euroing të vlerësohen si te pabazuara..

Operatori ekonomik ankues "Beni & Euroing" Suharekë, me datën:04 prill 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues-teknik.

Operatori ekonomik ankues "Laguna sh.p.k" - Prishtinë, me datën: 04 prill 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "Uni-Project sh.p.k-Prishtine , me datën: 05 prill 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues Agjencia Qendrore e Prokurimit, me datën: 04 prill 2017, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24.04.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, raporti i rivlerësimit të ofertave, njoftimi mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues:"Beni & Euroing" z.Kuqi deklaroi: Kompania jonë ka ofertuar në këtë aktivitet në 7 lote. Në lotet 1, 2, 4, 5, 6, 7 dhe 11, kërkesa e AK-së për këto 7 lote për shërbime të kryera ka qenë në vlerë 925.000€ ndërsa ne gjatë ofertimit kemi prezantuar kontrata dhe shërbime të kryera me vlerë 954,959.48€ të kryera gjatë tri viteve të fundit sipas kërkesës së dosjes së tenderit, konkretisht kërkesës 9.1 të FDT-së.

Në këtë kërkesë të dosjes është kërkuar "dëshmi për shërbime të kryera" dhe jo siç pretendon AK "kontrata të përfunduara", si dëshmi AQP që ka shpall fitues me kontrata të papërfunduara ua jap listën e kontratave gjatë tri viteve të fundit të OE fitues, OE fitues i këtij aktiviteti i ka prezantuar 16 kontrata, prej tyre vetëm 4 kontrata janë të përfunduara.

AK ka shpall fitues një OE me kontrata të papërfunduara, ndërsa neve na eliminon, kërkesa jonë është shumë e qartë, të respektohet dosja e tenderit, sepse OE-të ofertojnë në bazë të dosjes së tenderit. Konkretisht në pikën 9.1 ne ju kemi përmbajtur 100% kësaj pike.

AK në vlerësimin tonë nuk ka pranuar shërbime e kryera në KK Prishtinë, ne kemi si dëshmi një njoftim të AQP-së për furnizim me pemë dhe perime dhe shkruan "kontrata të përfunduara", AK ka bërë krahasim dhe thotë se ka bërë lëshim në këtë rast, mirëpo vlerësimi duhet bëhet sipas dosjes së tenderit. Kërkojmë nga paneli shqyrtues të kthehet lënda në rivlerësim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE:"Laguna" z.Ademi deklaroi: Pas njoftimit për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit kompania "Laguna" ka kërkaur qasje në dokumentet e ofertuesve dhe i është mundësuar qasja në dokumente , me 09.03.2017, në qasje të dokumenteve të cilët e kemi pasur ne kemi verifikuar edhe njëherë që "Laguna" e ka plotësuar dosjen e tenderit konform kërkesave dhe kritereve të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit.

Pretendimet e AK nuk qëndrojnë, vlen të potencoj se OE "LAGUNA" edhe njëherë është shpall fituese e këtij tenderi për lot.1 dhe lot.10, mirëpo OE tjerë pas ankesave të tyre lëndën e kanë dërguar në OSHP, pas kësaj OSHP ka marr një vendim 411/16, 413/16, 416/16 dhe 417/16, me të cilin thuhet "lënda të kthehet në Rivlerësim për lot.1, dhe lot.10, ku duhet të verifikohen referencat e OE të shpallur fitues".

Në këtë rast vlerësojmë se AK-AQP ka shkel nenin 59 të LPP-së me të cilin nuk e ka vlerësuar ekzaminuar dhe krahasuar dosjen e tenderit pas këtij vendimi.

Gjithashtu në këtë rast AK me letrën standarde që ka dërguar te "Laguna" thuhet që "vlera totale e dëshmive të përfunduara me sukses, shërbimet e pastrimit gjatë tri viteve të fundit sipas dosjs së tenderit për tri lote që ju keni ofertuar është kërkuar 1 milion euro, dhe vlera totale sipas dëshmive të prezantuara është 797.03€". Ky arsyetim i AK absolut nuk qëndron ngase OE "Laguna" ka ofertuar me tri kontrata dhe referenca siç janë kontrata e QKUK-së me referencë me vlerë 2,521,969.47€, kontrata e MPMS me referencë në vlerë prej 73,674.02€, dhe kontrata me MKK-së me referencë në vlerë 797.03€.

Këto janë tri kontrata të lidhura me institucione publike të Republikës së Kosovës dh referencat i kanë lëshuar këto autoritete të cilat janë të protokolluara dhe dëshmojnë qartë se OE Laguna ka përfunduar shërbimet e pastrimit mbi vlerën e kërkuar në dosjen e tenderit , pra mbi 1 milion euro, ose saktësisht 2,596,440.52€.

Vlen të cek se në letrën standarde thuhet se për tri lote që kemi ofertuar, është kërkuar 1 milion euro dhe vlera totale dëshmive është 797.03€.
Në këtë rast AK-AQP e ka marr për bazë një referencë e cila nuk është e përfunduar ndërsa dy tjera nuk i ka marr për bazë. Si dëshmi i kemi referencat të cilat janë kërkuar dhe të cilat janë të njëjta.

Në këtë rast OE "Laguna" shpk ka plotësuar në tërësi këtë kriter të dosjes së tenderit. Gjithashtu në qasje të dokumenteve zyrtare që kemi pasur, kemi has në një kërkesë për interpretim të cilin AK – AQP i ka kërkuar KRPP-së për interpretim, në këtë kërkesë të cilën AK – AQP ka kërkuar nga KRPP citoj "a pranohen si dëshmi referencat të cilat nuk janë të përfunduara, pasi që kriteret si kriter nuk është kërkuar kontrata të përfunduara por shërbime të përfunduara". Në këtë rast vet AK-AQP në njëfarë forme e pranon që nuk janë kërkuar kontrata të përfunduara por shërbime të përfunduara.

KRPP kthen një përgjigje AK-së se si është dashur të jenë kriteret sipas LPP-së, ndërsa cek edhe nenin 56.3 të LPP-së në të cilin thuhet që "tenderuesi gjatë procedurave të hapura, ose kandidati gjatë procedurave kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në bazë të një kërkese ose kriteri që nuk është cekur në njoftimin për kontratë dhe dosje te tenderit". Ky nen është shumë i qartë ngase nuk janë kërkuar kontrata të përfunduara por shërbime të përfunduara. Si dëshmi prezantoj edhe interpretimin që KRPP i ka dërguar AQP -së.

Ne si OE nuk duhet të jemi viktime në një rast kur AK-AQP nuk i ka formuluar kriteret siç duhet.

Ndërkaq sa i përket sigurimit të tenderit me të cilin pretendon se AK-AQP se nuk e kemi vazhduar, kjo absolut nuk qëndron ngase OE "Laguna" sa here është kërkuar e ka vazhduar edhe valditetin edhe sigurimin. Si dëshmi prezantoj sigurimet e vazhduara të kësaj oferte.

Si përfundim kërkojmë nga OSHP që të aprovohet ankesa e jonë dhe lënda të kthehet edhe njëhere në rivlerësim dhe që AK-AQP të veproj konform kërkesës së dosjes dhe njoftimit për kontratë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE:" Uni Project" z.Vrella i cili deklaroi:
OE "Uni Project" nuk pajtohet me përmbajtjen e ekspertizës për lot.1 dhe 10 pasi konsiderojmë subjektiv dhe jo ligjorë sipas nenit 113 par.1 të LPP-së.

Pikat kontestuese shkurtimisht i prezantoj në vijim.

Kompania "Uni Project" në ankesë ka prezantuar fakte – dëshmi për shërbimet e realizuara për tri vitet e fundit 2013-2014-2015, ku kemi ofruar dëshmi se kompania jonë gjatë kësaj periudhe ka kryer shërbime për të cilat kemi ofruar dëshmi në vlerë 3.6 milion euro, që tejkalon kërkesën e parashtruar nga AK, që ka qenë për 10 lotet ku ne kemi ofertuar ka qenë 2.025.000.00 €.

Pra sa i përket referencave kemi plotësuar në tërësi kërkesën e AK-së.

Në rast se AK ka pas nevojë të kërkoj sqarime shtesë rreth dokumentacionit të kërkuar atë ka mund ta bëj përmes dispozitave të LPP-së dhe jo të na eliminoj qysh në fazën e vlerësimit. Oferta e OE "Uni Projekt" për lotet 1 dhe 10 është më e ulëta e përgjegjshme në raport me OE-të tjerë, për shumën mbi 600.000€ për periudhë tri vjeçare. Sipas nenit 1 dhe 6 të LPP duhej shpall ofertë e përgjegjshme për shkak të parimit të ekonomicitietit dhe efikasitet për fonde publike për shërbimet e pastrimit.

Si konkluzion kërkojmë nga paneli i OSHP-së që pas shoshitjes së fakteve të marr vendim për aprovimin e aneksës për shkak se kemi plotësuar gjitha kërkesat dhe kushtet e kërkuara nga AK në dosje tenderit, dhe të merret vendim për dërgim të lëndës së kontestuar në Rivlerësim.

Si dëshmi i paraqes këtë dokument panelit, të njëjtin kemi në ofertë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK - AQP z.Rrukiqi konstatoi:
AQP lidhur me kërkesën për shërbime apo kontratat e përfunduara, ka marr interpretim në KRPP të cilin e ofroj OE "Laguna", dhe ne si AQP i jemi përmbajtur atij interpretimi dhe sipas atij interpretimi i kemi vlerësuar ofertat e OE të papërgjegjshëm.

Sa i përket sigurimit të ofertë së OE "Laguna" ne i kemi kërkuar valditetin dhe sigurimin e ka sjell me vonesë e jo sipas kërkesës së AK, mirëpo ka pas sigurim-ende pa i përfunduar sigurimi, mirëpo jo sipas kërkesës së AK.

Sa i përket OE "Uni Project" konsideroj se ky OE nuk i ka plotësuar kërkesat as për kontrata të realizuara as për gjendjen ekonomike financiare gjatë tri viteve të fundit. Me gjithë atë ky OE me vendim të OSHP është shpall i papërgjegjshëm dhe me rastin dt. 27.12.2016 vlerësojmë se është rast i gjykuar.

OE "Beni" për kontrata të realizuara vlen ajo që ceka si për "Laguna" që kemi vepruar sipas interpretimit të KRPP dhe ky OE është shpall i papërgjegjshëm me vendim të OSHP-së. Por vendimi i OSHP ka një mospërputhje me pjesën e fundit të vendimit, pasi edhe shpallet i papërgjegjshëm dhe njëkohësisht obligohemi të kërkojmë vazhdimin e validitetit dhe sigurimin gjithë OE-ve për lot.1 dhe lot.10, dhe ne kemi vepruar sipas vendimit të OSHP-së.
Ne pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në vazhdim përfaqësuesi i AK z.Rrukiqi deklaroj: Ne kemi respektuar vendimin e OSHP datës 27.12.2016, kemi formuar komisionin rivlerësimit dhe vlerësojmë se kanë vepruar në harmoni me LPP për shkak te natyrës së kësaj lënde.

Zyrtari përgjegjës i AQP-së ka përkrah vendimin e komisionit dhe kemi bërë anulimin e aktivitetit.
Me rastin e pranimit të ankesave lënda është shqyrtuar nga eksperti dhe kemi përkrahur ekspertizën e ekspertit dhe jemi pajtuar me të.

Në fund në qoftë se OSHP merr vendim të kundër me atë të datës 27.12.2016 për mua do jetë vendim i jashtëligjshëm, dhe për mua do ketë konotacione procedurale të mëtutjeshme.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z.Kurtishaj deklaroj: Bazuar në pretendimet ankimore të OE-ve ankues kam dhënë përgjigje në të gjitha pretendimet ankimore edhe pse dy prej ankesave kanë qenë në shumicën e përmbajtjes tyre prej ankesave të kaluara, me gjithë atë kam shpreh mendimin tim.

Në këtë aktivitet por edhe në përgjithësi në përmbajtje të ankesave është një çështje e kontestuar, OE-të ankues thirren se kërkesat në dosje dhe njoftim për kontratë kanë qenë "OE-të duhet të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar me sukses shërbime të pastrimit, gjatë tri viteve të fundit duke filluar nga data publikimit të njoftimit për kontratë", dhe nuk ka qenë që kontratat të jenë të realizuara.

Do i referohem më konkretisht kësaj kërkese, pasi un kam nda mendim të kundërt në raportin tim. Në kuadër të kësaj kërkese është dhënë edhe një sqarim e po ashtu edhe një shembull.

Do i referohem shembullit që lidhet me këtë kërkesë, ku thuhet "nëse shuma total e e kontratave për shërbimet e pastrimit të kërkuara për një lot është 150.000€, dhe për një lot dytë është 50.000€, atëherë kërkesa minimale e kontratave të realizuara e cila duhet të përmbushet nga OE-të është 200.000€". Vet shembulli sqaron a është kërkuar shërbime të realizuara apo kontrata të realizuara. Po ashtu te aneksi 8 i dosjes, OE-të kanë pas obligim të plotësojnë tabelën me të gjitha kontratat e realizuara sipas kërkesës ku thuhet "lista e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit duke filluar nga dita publikimit të njoftimit për kontratë" dhe thotë më tej "ky aneks është obligativ të plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që dokumenton liferimin e tillë".

Mbi këtë bazë kam ndarë mendimin që këtu duhet të ofrohen kontrata të realizuara tri vitet e fundit ,e jo pjesërisht të realizuara, ku kontratat janë të pa përfunduara dhe OE-të kanë marr referencë për atë

pjesë që e kanë kryer. Tani po te merret për bazë kjo që them unë, kontrata të realizuara, asnjë nga OE-të nuk plotësojnë këtë kusht. Po të merret e kundërta me shërbime të realizua, atëherë e plotësojnë që të tretë.

Unë mbes pran mendimit tim të dhënë në raport dhe i mbetet panelit të marr vendim për këtë çështje.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Ademi deklaroj: Ne kundërshtojmë edhe njëherë fjalimin e zyrtarit të AQP me të cilin pretendon që ka marr një vendim , në bazë të interpretimit të KRPP-së, ngase në interpretim të KRPP ceken kritere se si duhet të jetë sipas LPP-së, dhe nuk potencohet askund që kontratat duhet të kërkohen të përfunduara.

Si përfundim kërkojmë që lënda të kthehet në Rivlerësim dhe të vendoset sipas kritereve bnë njoftim për kontratë dhe dosjes së tenderit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Vrella deklaroj: Ne qëndrojmë pranë pretendimeve tona ankimore që ceka më lart, dhe njëkohësisht i drejtohem z.Rrukiqi se cila prej referencave të prezantuara nuk i ka përmbushur kërkesat e AK-së, pasi ne nuk kemi ofruar asnjë referencë jashtë kërkesave të AK. Në konkurrencën para ofertuese kemi pikat kryesore që ka theksuar AK , për dëshmitë e përvojës paraprake, ku shumë mirë është cek, si dhe formati i sigurimit të ofertës. Tani shohim që nuk kanë qenë format por me afat jo sipas kërkesës të AK dhe është befasi se si vlerëson AK me dy kuti.

I kërkojmë panelit shqyrtues që për lot 1 dhe lot 10 të kthehet lënda në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Kuqi deklaroj: Kërkesa jonë është që lënda të kthehet në Rivlerësim, dhe të respektohet pika 9.1 e dosjes kërkesa nr.1. Në bazë të kësaj kërkese ne si OE jemi të përgjegjshëm.

Sa i përket shembullit që potencoj eksperti, shembujt në dosje të tenderit nuk janë kritere vlerësuese.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Rrukiqi deklaroj: Me letër standarde OE është njoftuar me arsyet e eliminimit, si herën e parë dhe të dytë. Lidhur me konferencën para ofertuese, ligji ka ndryshuar, aktiviteti është ritenderuar dhe ndryshimet janë bërë sipas ndryshimeve të LPP-së. Ne qëndrojmë pranë vendimit të AK për anulim dhe i propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar.

Në fund eksperti shqyrtues z.Kurtishaj deklaroj: Qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresave të palëve në procedurë, deklarimit te OE ankuese ne seancë lidhur me ekspertizën, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se autoriteti kontraktues në dosje të tenderit ka kërkuar që operatorët ekonomik duhet të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar me sukses shërbime të pastrimit gjatë tri viteve të fundit, prandaj autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve duhet të bazohet në kërkesat e dosjes së tenderit ashtu siç i ka përcaktuar dhe vendosur vetë. Ndërsa në nenin 59 paragrafi 4 të LPP-së thuhet "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse*

tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Gjithashtu neni 56 paragrafi 3 i LPP-së e parasheh qartë që "*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*

Prandaj paneli shqyrtues duke u bazuar dispozitat që u cekën më lartë dhe në të gjitha dëshmitë relevante konstaton se autoriteti kontraktues duhet të ju përmbahet në tërësi kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht mos të eliminojë ndonjë operatorë ekonomik për kërkesa që nuk janë të parashikuara në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë.

Lidhur me arsyetimin e ekspertit shqyrtues/teknik se referencat duhet të paraqiten për kontrata të realizuara sepse kjo kërkesë buron nga dispozitat ligjore të nenit 69 paragrafi 4.2 të LPP-së, Paneli shqyrtues sqaron se nëse eventualisht do të kishte ankesa në lidhje me kërkesat dhe kriteret e vendosura në dosje të tenderit ka qenë afati i parashikuar për të bërë një gjë të tillë, ndërsa tani më ky aktivitet i prokurimit është në fazën e finale të dhënies së kontratës dhe autoriteti kontraktues duhet të ju përmbahet në tërësi kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, ashtu siç i ka parashikuar vetë autoriteti kontraktues.

Prandaj në këtë procedurë të prokurimit nuk janë respektuar neni 56, 59 dhe 62 të LPP-së.

Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Agjencia Qendrore e Prokurimit"

1x1 OE – "Beni shpk & Euroing shpk"- Suharekë

1x1 OE - "Laguna shpk" - Prishtinë

1x1 OE - "Uni-Projekt Sh.p.k"- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web faqe të OSHP-së.